

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN

“Magazininim dhe tregtim produktesh kimike, pesticide për bujqësi”

Vendndodhja: Maminas MAMINAS Rruga e vjetër nacionale Tiranë - Durrës, Km.21,
Objekt 3 katësh, Nr.38, Zona Kadastrale 3796, Nr.Pasurie 355/6, Durres.

Kërkues: Subjekti juridik “Arli Internacional” sh.p.k..

Administratori: z. Agim Rameta.

Shtator, 2021



TABELA PËRMBLEDHËSE

1.TË PËRGJITHSHME.....	3
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	9
2.1. Qëllimi i projektit	
2.2.Vendndodhja e aktivitetit	
2.3 Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike	
2.4. Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit	
3. INFORMACION PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.....	13
3.1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis	
3.2. Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve	
4.PROGRAMI I MONITORIMIT.....	14
4.1.Qëllimet e monitorimit mjedisor	
4.2. Objektivat e Monitorimit	
5. PËRPARESITË E PROJEKTIT/PËRFUNDIME.....	15





1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "ARLI INTERNACIONAL" me administrator z.Agim Rameta, është një subjekt juridik i regjistruar në QKB me NUIS J62424502N. Sipas ekstraktit të QKB-së, subjekti "ARLI INTERNACIONAL" është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar me 24.10.1996.

Zyra qendrore/zyra e përfaqësimit në Shqipëri është në adresën: Maminas, Rruga e vjetër nacionale Tiranë - Durrës, Km.21, Objekt 3 katësh, Nr.38, Zona Kadastrale 3796, Nr.Pasurie 355/6, Durres.

Subjekti "ARLI INTERNACIONAL", si objekt të veprimtarisë së tij ka:

Import,eksport,tregeti me shumice e pakice te medikamenteve veterinare,pesticide,plehra kimike,ushqimore apo blektorale, fara bujqesore,mallra te tjera industriale, Prodhim, perpunim, ambalazhim, magazinim te produkteve bujqesore, blegtorale, farera bujqesore, pesticide, plehra kimike, import, eksport I mallrave te ndryshem ushqimore, tregtim i tyre me shumice dhe pakice, sherbim restoranti dhe hotelerie, ne fushen e ndertimit, germime dheu, murature e beton arme, prishje dhe

punime toke te germuar, prodhime elemente parafabrikate betoni e beton arme te zakonshme e pararendur, gure dekorative, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore deri ne 5 kate dhe mbi 5 kate, rikonstruksione, ndertime banesa me skelet mbui 8 kate, ndertim rrugesht te te gjitha kategorive, punime mirembajtje dhe sinjalizimi ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore, ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 dhe mbi 10 metra, estakada, ura metalike, te varura, ndertim tunele rrugore, hekurudhore, ndertim ujesjellesa, kanalizime, kanale e impiante vaditese, punime karpentieri druri, ndertim diga e damba, projektim objekte civile, industriale, turistike etj, deri ne 5 kate, shtresa rrugore e sisteme asfaltimi, ura dhe vepra arti deri 10 metra, botim gazete, shtypshkrime, import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve pyjore, drurëve e degëzave të shqopës, të bimëve aromatike, medicinale, eterovajore, etj. Shkollë profesionale bujqësore. Kurse formimi profesional në fushën e bujqësisë si dhe për përdorimin e produkteve pest-control për mbrojtjen e

ambjenteve të mbyllura dhe të jashtme për dezinfektimin, dezinfektim dhe deratizimin. Qendër estekcioni (këshillimi) në fushën e bujqësisë, mbrojtja e bimëve, veterinari, frutikulturë, DDD pest-kontroll. Shkolle e Mesme Profesionale Bujqesore Jo-Publike per deget Agronomi-Veterinari. Institucion i Arsimit te Larte "Kolegj Profesional i Mjeksise Veterinare" Arli International. Prodhime pasticerie dhe akullore. Kurse të formimit profesional për kategoritë: guzhinier, picaiol, pastičier, banakier, kamarier.Teknologjia e perpunimit te : qumeshtit, mishit, vajit, fruta perimeve e pijeve.

Shoqëria ARLI INTERNACIONAL, përfaqësuar nga administratori z.Agim Rameta, kane ne pronesi pronen ku ndodhen objektet ku ushtrohet aktiviteti, sipas certifikates nr.1439470 per pronen me nr. 355/6, me siperfaqe 1493 m² (ndertese), ne zonen kadastrale 3796, volumi 6, faqe 184.

Dukë parë të gjithë fushën e veprimtarisë ku operon, subjekti kërkon zhvillon aktivitetin **"Magazinim dhe tregtim produkteve kimike, pesticide për bujqësi"**, me vendndodhje MAMINAS Rruga e vjetër

nacionale Tiranë - Durrës, Km.21, Objekt 3 katësh, Nr.38, Zona Kadastrale 3796, Nr.Pasurie 355/6, Durres.

Kjo zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi është një zonë me karakter shumë ekonomik dhe industrial.

Aktiviteti është në funksion prej shumë vitesh dhe subjekti është pajisur me Leje Mjedisi Tipi C me PN-9891-03-2020 për aktivitetin "Magazinimi i kimikateve", sipas Akt miratimit nr.7 prot date 3.3.2019.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË
DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR"**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	J62424502N
2. Data e Regjistrimit	15/12/1996
3. Emri i Subjektit	ARLI INTERNACIONAL
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	24/10/1996
6. Kohëzgjatja	Nga: 24/10/1996
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durres Maminas MAMINAS Rruga e vjetër nacionale Tiranë - Durrës, Km.21. Objekt 3 katësh, Nr.38, Zona Kadastrale 3796, Nr.Pasurie 355/6
8. Kapitali	12.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Import,eksport,tregeti me shumice e pakice të medikamenteve veterinarë,pesticide,plehra kimike,ushqimore apo blegtorale, fara bujqesore,mallra të tjera industriale. Prodhim, perpunim, ambalazhim, magazinim të produkteve bujqesore, blegtorale, farera bujqesore, pesticide, plehra kimike, import, eksport i mallrave të ndryshëm ushqimore, tregtim i tyre me shumice dhe pakice, shërbim restoranti dhe hotelerie, në fushën e ndërtimit, germime dhe, murature e beton armë, prishje dhe punime toke të germuar, prodhim elemente parafabrikate betoni e beton armë të zakonshme e pararendur, gure dekorative, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqesore deri në 5 kate dhe mbi 5 kate, rikonstruksione, ndërtime banesa me skelet mbui 8 kate, ndërtim rrugësh të të gjitha

1

Fig. 1 Pjese nga ekstrakti i subjektit



4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1439470

Zyra e Regjistrimit DURRES Zona Kadastrale Nr. 3796
Numri i Pasurisë 355/6^{na} Volumi 6 Faqe 184
Adresa e Pasurisë VLASHAJ
Lloji i Pasurisë NDËRTESE
Sipërfaqja Totale 1493.22
Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa 1493.22
Nga pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>ARLI</u>	<u>INTERNACIONAL</u>		<u>B</u>	<u>VLASHAJ</u>
<u>AGIM</u>		<u>RAMETA</u>	<u>B</u>	
<u>TIXHE</u>		<u>RAMETA</u>	<u>B</u>	

- është pronar i _____
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart 355/6^{na}
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V 355/6 , L 355/6 , J 355/6 , P 355/6

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 18.2.16 Nr. 3065

Data e lëshimit të certifikatës

15.03.2016

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI

[Signature]
DURRES

Fig. 2 – Certifikata e pronës




HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

DURRES

REGJISTRUESI I RRETHIT
ANI DYRMISHI



A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3796 NR. PASURISE 355/6-170 Vol. 6 FQ 184
 INDEKSI I HARTES K-34-8B-(228-A) SHKALLA 1:2500 SIP. 1493 m²
 ADRESA E PASURISE: Rrethi Durres /F VLAŠHAJ
 Rr./ _____ PjG _____ Sh. _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIME

V. PASURIA Nr. 355/6
 L. PASURIA Nr. 355/6
 J. PASURIA Nr. 355/6
 P. PASURIA Nr. 355/6

C. PRONARI

ARLI INTERNATIONAL
ETJ.

D. Data 01 / 03 / 2016 Ora 9³⁰

[Handwritten signature]




Fig. 3 – Harta treguese e prones



2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit të propozuar është magazinimi dhe tregtimi i produkteve kimike, pesticide për bujqësi.

Objekti do të shërbejë për magazinimin e përkohshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

2.2. Vendndodhja e aktivitetit

Prona për të cilën po vlerësohet zhvillimi i këtij aktiviteti ndodhet në MAMINAS Rruga e vjetër nacionale Tiranë - Durrës, Km.21, Objekt 3 katësh, Nr.38, Zona Kadastrale 3796, Nr.Pasurie 355/6, Durres.

Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Nr.	X	Y
	P.1.	4382815.6	4582589.71
	P.2.	4382839.5	4582549.67
	P.3.	4382677.79	4582491.32
	P.4.	4382663.7	4582532.09

Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH

Nr.	X	Y
P.1.	466351.76	4581587.66
P.2.	466375.56	4581547.9
P.3.	466214.56	4581487.7
P.4.	466200	4581528.3

Kjo zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona është me karakter shumë ekonomik dhe industrial. Pozicionimi përgjatë rruges kryesore dhe ne afersi te autostrafes Durres-Tirane, si edhe krijimi i rrugëve hyrëse dhe dalëse mundëson zhvillimin e shumë aktiviteteve dhe krijon lehtësira në aksesimin e tyre.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë përmbush kriteret bazë mjedisore për ushtrimin e aktivitetit:


- Nuk ndodhet pranë sipërfaqeve të urbanizuara (intensitet të lartë banimi);
- Nuk ka prani të burimeve ujore;
- Aksesimi për në pronë është i drejtëpërdrejtë.



2.3 Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike

Ortofoto e vendndodhjes së veprimtarisë

Objekti ku do zhvillohet aktiviteti në fjalë ndodhet në brendësi të pronës dhe nuk cenon pronat e tjera përreth. Zona e vendndodhjes së objektit ka infrastrukturë ekzistuese rrugore, rrjetin elektrik dhe rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm.



Pozicioni i pronës




Fig.4. Ortofoto e vendndodhjes së veprimtarisë (Sipas sistemit koordinativ- Albanian 1986/Gauss-Kruger Zone).

Burimi: geoportal.asig.gov.al






Fig nr. 5. Harta e distancave me objekte te tjera
 Burimi: geoportal.asig.gov.al




Fig nr. 6. Harta e distances se objektit me siperfaqe ujore
 Burimi: geoportal.asig.gov.al



2.4. Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit

Kompania Arli Internacional do të merret kryesisht me importimin dhe distribuimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Kompania ka kontrata me kompaninë prestigjioze nga vende të ndryshme të botës, si distributor dhe përfaqësues në Shqipëri të disa markave për kimikate dhe Produkte për Mbrojtjen e Bimeve (PMB).

Magazina do të shërbejë si vend magazinimi i përkohshëm për produkte për mbrojtjen e bimeve (PMB). Produktet do të jenë të ambalazuara direkt nga prodhuesi ose furnitore të ndryshme, dhe do të jenë të paketuara me kuti si dhe paletë të mbështjellur me qese plastike.

Gjatë vitit përafërsisht do të magazinohen rreth **20-25 ton PMB**.

Disa nga llojet e PMB –ve dhe klasifikimi:

Fungicide:

1. Previcur Energy SL (Propamocarb / Fosetil)
2. Nativo ËG (trifloksistrobin / tebukonazol)
3. Infinito SC (fluopikolid / propamokarb)
4. Melody Combi ËG (iprovalicarb / folpet)
5. Mikal Premium ËG (fosetil-al / folpet / iprovalikarb)
6. Prosper EC (spiroksamin)
7. Luna Experience SC (Fluopuram / tebukonazol)

Insekticide:

1. Decis EC (Deltametrin)
2. Confidor SL (Imidacloprid)
3. Confidor ËG (Imidacloprid)
4. Movento SC (Spirotetramat)

Herbicide:

1. Husar OD (jodosulfuron)
2. Equip OD (foramsulfuron)

3. INFORMACION PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.



Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale.

3.1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Shkarkime në ujë

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk kemi ndotje të ujërave nëntokesorë apo sipërfaqësorë. Ujërat që dalin nga aktiviteti janë ujera të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagies së zonës së objektit, dhe ujërat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Në objekt nuk do të magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore.

Emetimet në ajër.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, emetimet në ajër janë kryesisht: emetimet e gazeve që çlirohen nga lëvizja e automjeteve në zonë dhe pluhurat. Pra, mund të themi se niveli i shkarkimeve do të jetë i ulët, kjo vjen si rezultat se mjetet rrugore që qarkullojnë janë konform normave të përcaktuara.

Ndikimet në tokë.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë negativisht në tokë, kjo vjen si rezultat se nuk do të magazinohen lëndë të rrezikshme, pasi të gjitha kimikatet janë paketike të dedikuara dhe sipas standarteve ligjore perkatase.

Ndikimet në florë/ faunë.

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zonës në fjalë, pasi kjo zonë është e varfër me bimësi. Prona ku do të zhvillohet aktiviteti ka infrastrukture të ngritura. Në këtë prona është ndërtuar objekti me të gjitha intalimet e nevojshme për zhvillimin e këtij aktiviteti. Aktualisht zona është me karakter shumë ekonomik si edhe pozicionimi në zonë urbane jointensive kanë mbajtur larg faunën.

Mbetjet e prodhuara.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, mbetjet që do të prodhohen do të menaxhohen duke respektuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve do të jetë i diferencuar që në vendburim. Në ndihmë do të vijnë edhe konteineret e Njësisë Administrative perkatase.



Për një menaxhim të duhur të mbetjeve do të nënshkruhen kontrata përkatëse me subjektet e licensuara për trajtimin dhe menaxhimin e tyre.

3.2. Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmblëdhur si më poshtë shënuar.

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së aktivitetit;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis;
- Kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda objektit;
- Kontrolli i pluhurave nepërmjet lagjes së zonës;
- Kontrolli teknik i automjeteve për të parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe çlirimet tej normave të lejuara.
- Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia administrative.
- Instalimi i sistemit të ndarjes së ujrave të kanaleve të grumbulluara nga kanalet sipërfaqësore të objektit.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike të larjes dhe të shiut.
- Mbjellja e pemëve dekorative përreth objektit për të krijuar një ambient të pastër dhe rekreativ.

Do të respektohen të gjitha kushtet dhe masat në Lejen e Mjedisit që do të vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

4. PROGRAMI I MONITORIMIT

4.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

4.2 Objektivat e Monitorimit:



- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve. Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
 - Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
 - Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.
 - Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në zonë, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
 - Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
 - Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

5. PËRPARESITË E PROJEKTIT/PËRFUNDIME

- Pozicionimi përgjatë rruges kryesore si edhe krijimi i rrugëve hyrëse dhe dalje mundëson zhvillimin e këtij aktiviteti dhe krijon lehtësira në aksesimin e tij nga qytetaret.
- Gjatë funksionimit të tij nuk do të shkaktohet ndotje e tokës, ajrit, ujit.
- Me vendosjen e kontejnereve të veçantë për grumbullimin e mbeturinave që do të gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit, dhe nënshkrimi i kontratave me subjektet e licensuara për trajtimin e tyre, do të zgjidhet problemi i trajtimit të tyre dhe në të njëjten kohë do të parandalojë ndotjen e mjedisit.



Pamje nga objekti ku zhvillohet aktiviteti.



